



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 3632 Prot

Shkodër, më 14.11.2017

**URDHËR nr. 327**

(Për administrimin e procesit të mbledhjes dhe shqyrtimit të rasteve përjashtimore nga tarifa e shkollimit)

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 112, ligjin nr.10296 dt.08.07.2010" Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr.9936 date 26.6.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne republiken e Shqiperise" me ndryshime, VKM nr. 269, datë 29.3.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", vendimit te Bordit te Administrimit nr.64, dt.13.10.2017 "Per miratimin e tarifes se shkollimit per vitin akademik 2017-2018"

**Urdhëroj:**

1. Fillimin e procesit të pranimit të aplikimeve për përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2017-2018.
2. Afati i aplikimit është deri me dt.31.12.2017.
3. Sekretaritë e dekanëve pranojnë aplikimet për përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2017-2018, sipas afatit të sipërcituar.
4. Pas përfundimit të afatit komisioni i përbërë nga

- Suzana Lika
- Saida Bizaku
- Florinda Arrinaj





merr në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar me protokoll nga sekretaritë e dekanëve përkatës dhe përpilon relacionin përfundimtar, të cilin ia kalon drejtorisë së financës, për të vijuar procedurat ligjore të miratimit në bordin e administrimit, një muaj pasi merren në dorëzim nga sekretaritë.

5. Specialistja e financës Saida Bizaku e pajisur me user-in për akses në portalin e –albania, do të gjenerojë nga sistemi on-line certifikatat familjare apo personale të çdo aplikanti, pasi ky i fundit ka dhënë pëlqimin për administrimin e të dhënave personale (certifikata).
6. Bashkëngjitur këtij urdhri kopje e vendimit të BA dhe e njoftimit përkatës i publikuar në website.
7. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen dekanët e fakulteteve, sekretaritë e dekanëve dhe komisioni i ngritur për këtë qëllim.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Administratore e komanduar**

**Eriklida SHPORI**

**REKTORI**

**Prof. dr. Adem BEKTESHI**